



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 71, datë 27.10.2024

“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË 2025”

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 38, të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, pika 4/a e VKM nr.362, datë 29.05.2019 për “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet Buxhetit të Shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, si dhe Urdhërit Nr. 745 datë 07.10.2024 për “Ngritjen e grupit të punës për miratimin e vlerës mesatare sipas strukturës së apartamenteve në treg të lirë” me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Gjirokastrë, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar Leke
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	Muaj	1	10.000
2	Banesa me qira (Apartament 1+1)	Muaj	1	15.000
3	Banesa me qira (Apartament 2+1)	Muaj	1	19.000
4	Banesa me qira (Apartament 3+1)	Muaj	1	24.000

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt-vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT  
Etleva YZO

KRYETAR I KËSHILLIT  
Merita ISARAJ

